

RAPORT HULUMTIMI
ZHDUKJA E GJURMËVE – Qendrat historike të Kosovës
Shtator 2015, Prizren

PËRMBAJTJA

I. Përmbledhje ekzekutive	2
II. Hyrje	2
IV. Metodologjia	4
IV. Gjendja e qendrave historike	4
<i>Qendra historike e Prishtinës</i>	<i>4</i>
<i>Qendra historike e Prizrenit</i>	<i>6</i>
<i>Qendra historike e Gjakovës</i>	<i>8</i>
<i>Qendra historike e Mitrovicës</i>	<i>9</i>
<i>Qendra historike e Rahovecit</i>	<i>11</i>
<i>Qendra historike e Gjilanit</i>	<i>11</i>
<i>Qendra historike e Pejës</i>	<i>13</i>
<i>Qendra historike e Vushtrrisë</i>	<i>15</i>
V. Rekomandime	16
VI. Konkluzion	18
EC Ma Ndryshe	19

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm”, i përkrahur financiarisht nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përmbajtja dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim i përkasin organizatës jo-qeveritare EC Ma Ndryshe.

I. Përmbledhje ekzekutive

Ky raport i shkurtër hulumtimi ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të përgjithshme mbi statusin e mbrojtjes së qendrave historike urbane në Kosovë. Në vazhden e përpjekjeve për avokim për rend urbanistik, ndalimin e degradimit të trashëgimisë dhe promovimit të një zhvillimi të qëndrueshëm të qyteteve në Kosovë, EC Ma Ndryshe kësaj radhe vë në fokus të diskutimit qendrat historike të disa qyteteve në Kosovë. Për shkak të kaosit ndërtimor të pasluftës, shkeljeve të rregullave urbanistike, neglizhencës institucionale, moskoordinimit ndërmjet institucioneve kryesore qendrore dhe lokale në fushën e trashëgimisë dhe planifikimit hapësinor, si dhe mungesës së mbrojtjes ligjore të përhershme, e shumë faktorëve të tjerë, këto qendra çdo ditë e më shumë po vazhdojnë të pësojnë dëmtime të pakthyeshme dhe po rrezikojnë shlyerjen e plotë të kujtesës kolektive të atyre qyteteve.

Ky hulumtim, në këtë moment, nuk ka për qëllim t'iu japë përgjigje të gjitha problemeve që dalin nga kaosi urbanistik me të cilin përballemi përditë në qytetet tona, por mëton të ndihmojë në identifikimin e disa instancave të cilat kontribuojnë, përditë e më shumë, në degradimin e bërthamave historike në Kosovë. Qendrat historike urbane në Kosovë po zhduken dhe përgjegjësia për t'i mbajtur gjallë është kryekëput e të gjithë qytetarëve të Kosovës, dhe në veçanti e institucioneve të Kosovës, të cilët duhen të sigurojnë mekanizma që ta parandalojnë degradimin dhe të promovojnë trashëgiminë në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm të qyteteve tona. Prandaj shpresojmë se ky raport i shkurtër, që ngre shqetësimin mbi gjendjen e qendrave tona historike, të shërbejë si shkas për thellimin e hulumtimeve të mëtutjeshme të profesionistëve rreth problemeve të mbrojtjes së qendrave historike dhe të përshejtojë adresimin e çështjeve që lidhen

me ruajtjen dhe konservimin në përgjithësi të këtyre të mirave tona të përbashkëta.

II. Hyrje

Rritja e pakontrolluar urbane është një nga shqetësimet në rritje në të gjithë botën. Një problem i madh i qenësishëm në rritjen e pakontrolluar të qyteteve është kërcënimi që ajo paraqet për trashëgiminë e brishtë kulturore dhe ekologjike, gjendja e të cilës mund të përshkallëzohet në dëmtime të përhershme dhe të pakthyeshme.

Zonat urbane historike ose bërthamat historike janë ndër manifestimet më të rëndësishme dhe më të llojllojshme të trashëgimisë sonë kulturore të përbashkët, të cilat janë formuar nga brezat e ndryshëm, dhe përbëjnë një dëshmi të rëndësishme për të kaluarën dhe të tashmen, si dhe për përpjekjet dhe aspiratat e njerëzimit në mbarë botën.¹ Ato paraqesin zona të qytetit të përkufizuara, që përmbajnë një numër të koncentruar të objekteve/tërësive, të cilat kanë një vlerë ose më shumë vlera që ndër lidhen në aspektin historik, arkitekturor, arkeologjik ose kulturor.² Ato paraqesin artefaktet kryesore që i japin formë kujtesës kolektive të një qyteti dhe identitetit me të cilin një komunitet lidhet.

Në territorin e Kosovës gjenden gjurmë të vendbanimeve qysh prej periudhave më të hershme. Lokacione të shumta arkeologjike dëshmojnë për qendra urbane, të cilat prej kohësh janë shuar. Por, një numër i këtyre vendbanimeve, për shkak të pozitës së vet gjeografike, administratës, ekonomisë, tregtisë dhe rëndësisë gjeostrategjike, vazhduan të zhvillohen dhe zgjerohen, dhe

¹ Recommendation on the Historic Urban Landscape, including a glossary of definitions (10 November 2011); http://portal.unesco.org/en/ev.php-URL_ID=48857&URL_DO=DO_TOPIC&URL_SECTION=201.html, qasur në 21 korrik 2015

² Po aty

paraqesin bërthamën mbi të cilën u ngrihen qytetet që i jetojmë sot. Një nga tiparet themelore të këtyre qyteteve është se janë zhvilluar në mënyre spontane gjatë të gjitha epokave, sikurse edhe në periudhën e Perandorisë Osmane. Në strukturën e vet urbanistike, askund nuk gjejmë tërësi të kompozuar: sheshe të formësuar me plan, ndërtesa publike të grupuara, kopshte publike të mbjella dhe të formësuar në mënyrë të planifikuar, etj. Kështu ka lindur edhe tipari karakteristik i strukturës urbane të këtyre qyteteve: një parregullsi e madhe e të gjithë elementeve themelore të rrugëve, blloqeve, shesheve, brigjeve të lumenjve etj.³

Mirëpo, rritja dhe modernizimi i këtyre qyteteve, qysh prej periudhës së pasluftës së dytë botërore, edhe pse kësaj radhe bëhet, ndryshe prej zhvillimeve spontane të mëhershme, sipas planeve të hartuara nga profesionistë të urbanizimit dhe të cilat, mes tjerash, mëtojnë të vënë rregull, të fusin infrastrukturën themelore dhe të ngrënë cilësinë e të jetuarit në qytet, fillojnë të shlyejnë gjurmët e të kaluarës së qytetit. Intervenimet e tilla shkatërruese, në shumicën e rasteve u prirën prej një leximi ideologjik të asaj kujtese të qytetit, por jo rrallë intervenimet e tilla të pamëshirshme kishin për qëllim realizimin e prioriteteve të një agjende moderne të urbanizimit, e që ishin krijimi i hapësirave të mjaftueshme për zhvillimet moderne, siç janë ndërtesat shumëbanesore, të administratës moderne, rrugët automobilistike, etj. Si pasojë e këtyre intervenimeve sot nuk kemi më gjurmë nga çarshia e Prishtinës, çarshia e Mitrovicës, çarshia Arasta e Prizrenit, etj.

Në të njëjtën kohë, bëhet përpjekja e parë për vendosjen nën mbrojtje të shtetit të ndërtimeve të veçanta dhe ansambleve, çarshive, etj. Në vitet e '50 të shekullit të

kaluar, kur në botë tashmë ishin në fuqi kartat themelore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (karta e Athinës dhe e Venedikut), filloi vënia nën mbrojtje ligjore të disa ndërtesave dhe ansambleve, si dhe përcaktimi i sipërfaqeve që u quajtën qytet i vjetër, zonë e vjetër a ngjashëm. Prej asaj kohe kemi tentativat për caktimin e e zonës së vjetër të Prishtinës⁴, vënien nën mbrojtje të Shtëpisë së Emin Gjikut në Prishtinë, Çarshisë së Pejës, Çarshia e Gjakovës, etj.

Në fund të viteve të '70 të shekullit të kaluar u bënë përpjekjet e para që të hartohen planet urbane detale dhe studimet për të vendosur ligjshmëritë dhe parimet e konservimit të atyre zonave, si dhe për të kufizuar aktivitetet ndërtimore përbrenda bërthamave historike të qytetit, siç ishte rasti i studimit mbi çarshinë e Gjakovës, me ç'rast u hartua edhe një studim i detajuar, i cili përcaktonte rregullat dhe ligjshmëritë e intervenimeve në atë zonë. Në atë periudhë, në Prishtinë u hartua "Plani Urbanistik Detal i Zonës Historike të Qytetit me Qendër Zejtare", i cili po ashtu rregullon natyrën e zhvillimit urban të asaj zone të qytetit.

Gjatë luftës së fundit në Kosovë, trashëgimia ndërtimore nuk u kursye nga aktivitetet luftarake. Ndërtimet individuale dhe ansamble të tëra, duke përfshirë këtu edhe bërthama të tëra historike të qyteteve si Gjakova, Peja, Mitrovica, ishin cak i shkatërrimeve të mëdha. Paslufta i gjen qytetet e Kosovës me infrastrukturë dhe lagje të tëra të shkatërruara. Vlugu i rindërtimit, në fillim i prirë nga nevoja për strehim emergjent, e më vonë i prirë nga interesat private, me vakuumin ligjor në fillim, dhe

⁴ Xërxa, F. Qendra e Prishtinës numëron ditët e fundit, OJQ EC Ma Ndryshe, Prizren, tetor 2014, http://www.online-transparency.org/repository/docs/141003121711_RAPO_RT_Qendra_Historike_e_Prishtines.pdf, qasur në 20 korrik 2015.

³ Kojic, B., Balkanski gradovi, varosi i varosice. Zavod za Urbanisticko Arhitektonski Razvoj, Beograd, 1975

neglizhencën e institucioneve të pushtetit lokal para së gjithash, më pas, për trashëgiminë ndërtimore, veçanërisht në bërthamat historike, kishte pasoja pothuajse fatale. Në disa qytete, ajo që dikur pretendohet të ishte pjesë e vjetër e qytetit, u popullua me ndërtime të larta, të ngjeshura pranë njëra-tjetrës, pa respektuar asnjë normativë urbane e ndërtimore. Në shumë qytete peizazhi historik urban është dëmtuar, nëse jo edhe zhdukur tërësisht, dhe janë të pakta elemente të mbetura që vazhdojnë të ngjallin reminishencë të asaj që dikur paraqiste ajo pjesë e qytetit. Sot jemi përballë një situatë dramatike, që shpeshherë çon në dëme të pakthyeshme kulturore, sociale dhe humbje ekonomike, përbrenda një ngërçi politik dhe ekonomik, që dekurajon ruajtjen e këtyre pasurive kulturore, që e përbëjnë kujtesën e njerëzimit. Është momenti i fundit që institucionet tona, por edhe mbarë shoqëria kosovare, të ndërmarrin hapa serioz drejt mbrojtjes, konservimit dhe restaurimit të bërthamave historike urbane në qytetet tona, por edhe zhvillimit dhe adaptimit të tyre me rrjedhat e jetës bashkëkohore⁵.

III. Metodologjia

Ky raport hartohet për 8 qytete të Kosovës: Prishtinën, Prizrenin, Gjakovën, Pejën, Gjilanin, Mitrovicën, Vushtrrinë dhe Rahovecin. Përzgjedhja e tyre u bë duke u bazuar në historikun e zhvillimit të tyre si qendra urbane, bërthamat historike, gjurmët e të cilave vazhdojnë të jenë evidente; dokumentet e mëhershme që dëshmojnë përpjekjen për ta bërë përkufizimin dhe ruajtjen e tyre. Faktor i rëndësishëm për përzgjedhjen e këtyre qyteteve ishte edhe

prania e një numri më të madh të ndërtimeve që janë në listën e mbrojtjes së përkohshme të MKRS-së, edhe të atyre që, edhe pse nuk janë në atë listë, sipas qytetarëve kanë vlerë për historinë e qytetit. Të dhënat themelore për bërthamat historike dhe statusin e mbrojtjes së tyre janë marrë nëpërmes komunikimit me drejtoreshën e Drejtorisë së Trashëgimisë në MKRS, KKTK-në, ORTK-të, drejtoritë komunale të Urbanizmit, CHWB-në, etj. Të dhënat tjera janë nxjerrë duke i konsultuar edhe planet hapësinore të komunave përkatëse, planin hapësinor të Kosovës, dokumentet e CHWB-së, dhe publikimet tjera.

IV. Gjendja e qendrave historike

Qendra historike e Prishtinës

Përkufizimi i kufijve të zonës së mbrojtur: “Zonë historike” apo “Qyteti i vjetër” u quajt bërthama historike e qytetit të Prishtinës e përkufizuar sipas Planit Urbanistik Detal të vitit 1978. Kjo zonë u shpall në mbrojtje qysh në vitin 1951 kur u hartua Plani Gjeneral dhe me të njëjtën rëndësi u trajtua edhe në Planin Gjeneral të vitit 1964. Sipas planit detal të vitit 1978, zona e qytetit të vjetër bashkë me qendrën artizanale ishte 26 ha. Me emërtimin “Qendër Historike” nënkuptohet bërthama historike e definuar sipas Planit Strategjik të Zhvillimit Urban të Prishtinës, i vitit 2001. Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor (nr. 2003/4) dhe Ligjit për Rregullimin e Vetëqeverisjes së Komunave të Kosovës (nr. 2000/45), në vitin 2006 Kuvendi komunal i Prishtinës mori vendim për iniciimin e hartimit të një plani rregullativ për “Qytetin e vjetër” të Prishtinës, kufijtë e të cilit ishin përshkruar në nenin 3 të vendimit, që përfshin një sipërfaqe prej 26 ha. Në vitin 2009 u plotësua vendimi i vitit 2006, duke i zgjeruar kufijtë, me ç’rast kjo zonë, tashmë e referuar si “Qytet i

⁵ Charter for the Conservation of Historic Towns and Urban Areas (Washington Charter 1987), http://www.international.icomos.org/charters/towns_e.pdf

vjetër” përfshinë një sipërfaqe prej 42 ha”.⁶ Në vitin 2014, me vendim të MKRS-së dhe në bashkëveprim me drejtorinë e urbanizmit të komunës së Prishtinës, u formua një grup punues në kuadër të MKRS-së, me ekspertë të trashëgimisë, me qëllim të përcaktimit përfundimtar të zonës me kufij të rinj dhe inicimit të procesit të vënies nën mbrojtje ligjore. Ky grup punues ende vazhdon punimet.




Fig. 1 Harta e zonave të mbrojtura të monumenteve arkitekturore në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme për qytetin e Prishtinës, punuar nga EC Ma Ndryshe⁷

Statusi i mbrojtjes së zonës: Në planin gjeneral të vitit 1951, kjo zonë e qytetit u quajt “Zonë historike”, apo qyteti i vjetër. Njësoj u trajtua edhe në Planin Gjeneral të vitit 1964. Sipas përshkrimit në “Planin Urbanistik Detal të Zonës Historike të Qytetit me Qendër Zejtare”, të punuar në vitin 1978, vendimi për të punuar Planin Urbanistik Detal të kësaj zone erdhi nga Plani Gjeneral i vitit 1951. Plani gjeneral i miratuar në vitin 1987, gjithashtu i konfirmoi parimet themelore lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë ndërtimore në Zonën Historike të promovuara

në aktet e mëparshme.⁸ Nga grupi punues, i themeluar nga MKRS, pritet që të vendoset mbi statusin përfundimtar të mbrojtjes ligjore të kësaj zone.

Në listën e MKRS-së së ndërtimeve dhe tërësive të trashëgimisë nën mbrojtje të përkohshme, për qytetin e Prishtinës, deri më tash gjenden rreth 26 objekte dhe tërësi të trashëgimisë arkitekturore. Një numër nga to janë me vendime të mbrojtjes të fituara qysh në vitet ‘50 të shekullit të kaluar. Numri më i madh i tyre gjendet në dhe pranë bërthamës historike të qytetit. Disa nga pronat e rëndësishme të trashëgimisë që gjenden në bërthamën historike të Prishtinës janë:

1. Xhamia e Mbretit, viti 1461, nr. vendimit 848/1953
2. Shtëpi banimi (ish-ASHAK), shek XIX, nr. vendimit 952/1953
3. Kompleks banimi (Emin Gjiku), shek. XVIII - XIX, nr. vendimit 953/1953
4. Shtëpi banimi (IMMK), shek. XIX, nr. vendimit 731/1957
5. Hamami i Madh, shek. XIV – XV, nr. vendimit 632/1985
6. Kompleksi i Çarshisë së vjetër të Prishtinës me Çarshi Xhaminë (shek. XIV), xhaminë e Jashar Pashës, Shadërvanin e vjetër, sahat Kullën dhe Muzeun e Kosovës, nr. vendimi 02-278/67

Lista e plotë e monumenteve nën mbrojtje të shtetit gjendet në versionin e përditësuar të Listës së Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme.⁹

⁶ Xërxa, F. Qendra e Prishtinës numëron ditët e fundit, OJQ EC Ma Ndryshe, Prizren, tetor 2014, http://www.online-transparency.org/repository/docs/141003121711_RAPO_RT_Qendra_Historike_e_Prishtines.pdf, qasur në 20 korrik 2015.

⁷ <http://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,188#.Vd3hPiWqpBc>, qasur më 26 08 2015

⁸ Xërxa, F. Qendra e Prishtinës numëron ditët e fundit, OJQ EC Ma Ndryshe, Prizren, tetor 2014, http://www.online-transparency.org/repository/docs/141003121711_RAPO_RT_Qendra_Historike_e_Prishtines.pdf, qasur në 20 korrik 2015.

⁹ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/LISTA_E_TRASHËGIMISE_KULTURORE_PER_MBROJTJE_TE_PERKOHSHME_2014.pdf

Planet rregulluese dhe konservimi: Deri më tani, për këtë zonë, është punuar një plan detal urbanistik i zonës historike të qytetit dhe qendrës zejtare.¹⁰ Ky plan përcakton ligjshmëritë se si duhet të zhvillohet kjo zonë. Deri më tash nuk ka një plan tjetër rregullues dhe pritet pasi të përkufizohen çështjet rreth kufijve dhe statusit të mbrojtjes, të punohet tutje në këtë drejtim. Gjithsesi, një studim për masat e konservimit do të duhej t'i paraprinte një plani të ri hollësishëm për këtë zonë.




Fig. 2 Kufijtë e Qendrës Historike të Prizrenit sipas Planit të Konservimit të Prizrenit, viti 2009

Qendra historike e Prizrenit

Përkufizimi i kufijve të zonës së mbrojtur: Plani Zhvillimor Urban 2004 - 2013 Zonën Historike të Prizrenit e përkufizon me kufijtë e saj si zonë e parë e mbrojtur, ndërkaq gjetiu e njëjta mund të gjendet e quajtur edhe si qendra historike e qytetit të Prizrenit, apo zona historike e qytetit të Prizrenit. Kjo zonë, me Planin e Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, që është një Plan Rregullues Urban (PRrU) punuar dhe miratuar nga kuvendi komunal i Prizrenit në vitin 2009, përmban brenda kufijve të vet zonat si më poshtë¹¹:

1. Zona tradicionale e tregut
2. Zona e bllokut të ndërtesave të larta
3. Zona e shtratit të lumit
4. Zona e nënkalasë
5. Zona e rrugës tregtare
6. Zona e përdorimit të përzier dhe banimit
7. Zona e banimit (organike)
8. Zona e banimit (në trendet e ndërtimit)

Statusi i mbrojtjes së zonës: Përpjekjet për të mbrojtur bërthamën historike të Prizrenit kanë qenë të shumta qysh pas Luftës së Dytë Botërore. Janë bërë studime dhe propozime konkrete për mbrojtjen dhe revitalizimin e qendrës historike gjatë viteve 1968 - 74. Asokohe kishte tendencë që Prizreni të vihej në listën e UNESCO-s si qytet me vlera kulturore, por pa rezultate konkrete¹². Këto në një mënyrë ndikuan që bërthama historike e këtij qyteti të pësonte në masë të madhe nga zhvillimet moderne të pas Luftës së Dytë Botërore. Përkundër studimeve të shumta për qytetin që u bënë nga studiues të shumtë nga Kosova dhe ish - Jugosllavia, si në aspektin e historikut të zhvillimit urbanistik, por edhe tipologjive të banimit, në përgjithësi, nuk kishte as një plan zhvillimor të qytetit¹³ për t'i përkufizuar kahet e zhvillimit dhe zgjerimit të qytetit.

Përpjekje serioze për ta vënë nën mbrojtje bërthamën historike nisën në periudhën e pas luftës së fundit, kur edhe paraqiten studimet

¹⁰ "Planin Urbanistik Detal të Zonës Historike të Qytetit me Qendër Zejtare", të punuar në vitin 1978, Enti Urbanistik i Komunës së Prishtinës

¹¹ Plani i konservimit dhe zhvillimit të zonës historike të Prizrenit, Përparësitë dhe sfidat e implementimit, Report Series No. 22/2011, CHwB http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2011_12.pdf

¹² Xhibo, J., Implementimi i Planit të Konservimit dhe Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit – Sfidat e mbrojtjes së zones historike të Prizrenit, fq. 162, Plani i konservimit dhe zhvillimit të zonës historike të Prizrenit, Përparësitë dhe sfidat e implementimit, Report Series No. 22/2011, CHwB http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2011_12.pdf

¹³ Po aty.

e para dhe planet e dokumentet e para¹⁴, por edhe përpjekjet për inventarizimin për mbrojtje të monumenteve dhe zonave nga Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve IMM dhe CHwB në vitin 2006. Paraprakisht (2005) ishin kryer disa studime të koordinuara nga politekniku i Torinos, Itali, dhe me përkrahjen nga CHwB-ja, të cilat i përvijonin disa nga normativat për ruajtjen e kësaj zone¹⁵. Bazuar në të gjitha këto, Procesi i hartimit të Planit të Konservimit dhe i Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit filloi më 2005 dhe ajo zyrtarisht u aprovua në 2009 si Plan Rregullues Urban për qendrën historike të Prizrenit.

Qyteti i Prizrenit ka numrin më të madh të pronave të trashëgimisë të vëna në mbrojtje të shtetit. Lista e plotë e monumenteve nën mbrojtje të shtetit gjenden në versionin e përditësuar të Listës së Trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme¹⁶.

Plani i konservimit: Procesi i hartimit të Planit të Konservimit dhe i Zhvillimit për zonën historike të Prizrenit filloi më 2005 dhe ajo zyrtarisht u aprovua në 2009 si Plan Rregullues Urban për qendrën historike të Prizrenit. Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit është një Plan Rregullues Urban (PRRU) ligjërish i miratuar, i cili mbulon hapësirën e përshkruar si "Zonë Historike e Prizrenit". Ky plan jep masat e

ruajtjes dhe/apo konservimit të bërthamës historike të Prizrenit dhe jep kahet për rregullimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të saj. Në këtë PRRU përcaktohen objektivat e planifikimit si dhe udhëzimet për ndërtim në këtë zonë. Qendra historike e Prizrenit, është e klasifikuar si zonë e veçantë e mbrojtur dhe është e mbrojtur edhe nga Ligji 04/L-066, që përcakton rregullat për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor të qëndrueshëm të saj si pronë e trashëgimisë kulturore dhe historike në mbrojtje të përhershme me vlera të interesit lokal, shtetëror dhe ndërkombëtar¹⁷.

Duhet theksuar edhe se brenda qendrës historike të Prizrenit gjendet edhe prona e trashëgimisë, Kisha e Shën Premtes - Levishka, e cila është e mbrojtur nga UNESCO, në kuadrin e Monumenteve të Mesjetës në Kosovë. Kjo pronë është e vënë nën mbrojtje në vitin 2006, me ID 724-003bis me sponsorim nga Serbia¹⁸.

Qendra historike e Prizrenit sot: Aktualisht, në përditësimin e fundit të listës së MKRS-së së trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të shtetit, vetëm në qytetin e Prizrenit janë mbi 87 ndërtime të evidentuara, që gëzojnë mbrojtje por edhe janë të evidentuara në databazën e trashëgimisë të MKRS-së. Edhe pse, ndryshe prej qyteteve të tjera në këtë hulumtim, plani ekzistues i konservimit, por edhe ligji për këtë zonë të veçantë, do të duhej të siguronte dhe të përcaktonte rregullat për ndërtim, zhvillim, por para së gjithash mbrojtje në këtë zonë, sot, 6 vite pas aprovimit të këtij plani, në qendrën historike të Prizrenit, degradimi nuk ndalon. Institucionet e nivelit lokal dhe qendror, QRTK-ja, por edhe KZM-ja, deri më tani kanë

¹⁴ Forumi Europa Nostra dhe Takimet përgatitore 2006; Plani Zhvillimor Urban - Kuvendi Komunal i Prizrenit dhe Nixha Partners, 2003, fq. 12, Plani i konservimit dhe zhvillimit të zonës historike të Prizrenit, Përparësitë dhe sfidat e implementimit, Report Series No. 22/2011, CHwB http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2011_12.pdf

¹⁵ Plani i konservimit dhe zhvillimit të zonës historike të Prizrenit, Përparësitë dhe sfidat e implementimit, Report Series No. 22/2011, CHwB http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/07/Publication_2011_12.pdf

⁸ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/LISTA_E_TRASHEGIMISE_KULTURORE_PER_MBROJTJE_TE_PERKOHSHME_2014.pdf

¹⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 20 / 18 korrik 2012, Prishtinë; Ligji Nr. 04/L-066 Për Qendrën Historike të Prizrenit, <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2836>

¹⁸ <http://whc.unesco.org/en/list/724>

dështuar në parandalimin e dëmtimit dhe shkatërrimit të pjesëve të tëra të kësaj zone. Po ashtu, ata kanë dështuar edhe në implementimin e normativave të përcaktuara për ndërtim në këtë zonë. Për të siguruar implementimin dhe zhvillimin e kësaj zone, hapi tjetër që duhet të ndërmerret është hartimi i një plani të menaxhimit¹⁹ të kësaj zone, por edhe aktivizimi i inspektorëve të trashëgimisë²⁰, të cilët do të monitoronin në baza të rregullta aktivitetet ndërtimore, apo edhe intervenimet e tjera që zhvillohen në këtë zonë.

Qendra historike e Gjakovës

Përkufizimi i kufijve të zonës së mbrojtur: Bërthama historike e Gjakovës, mes tjerash, karakterizohet me çarshinë e qytetit, dhe është pikërisht ajo që ka gëzuar mbrojtje nga shteti prej kohësh. Kufiri i çarshisë është i përcaktuar në dokumentin "Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë", në dhjetor të vitit 1979. Në vitin 1982 u nxor vendimi për planin e rregullimit të "Çarshisë së Madhe" në Gjakovë²¹.

Këta kufij dhe ky vendim për planin e rregullimit janë marrë duke u bazuar në vendimin për mbrojtjen e çarshisë së Gjakovës, më 19 shkurt 1955²². Shtrirja e kësaj zone, të përkufizuar sipas studimit të

mësipërm, në drejtim veri - jug është rreth 1000 m', dhe sipërfaqja e zonës është 34.000 m². Sipas ark. Osmon Gojani, nga institucionet lokale në qytetin e Gjakovës, është duke u konsideruar zgjerimi i kufijve të kësaj zone, dhe për këtë tashmë janë duke u bërë disa studime.




Fig. 3 Shtrirja e çarshisë së Gjakovës²³

Statusi i mbrojtjes së zonës: Vendimi me të cilin çarshia e Gjakovës u vu nën mbrojtje, u mor në më 19 shkurt 1955, (vendimi nr. 59/55). Në emrin "Tërësia urbanistike - Çarshia e madhe" kjo zonë mban nr. rendor 390, në listën e MKRS-së të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje të përkohshme, si dhe mban numrin unik të databazës 000334²⁴.

Planet e konservimit: Në dokumentin "Studimi i Regjenerimit dhe Revitalizimit të Çarshisë së Madhe në Gjakovë", të dhjetorit të vitit 1979, mes tjerash, janë përcaktuar disa nga aspektet e konservimit të pjesëve të kësaj zone. Ky studim i parapriu vendimit të nxjerrë më 1982 për planin e rregullimit të "Çarshisë së Madhe" në Gjakovë. Në fillim të vitit 2015, zyra e CHWB në Kosovë në bashkëpunim me partnerë të institucionet lokale dhe qendrore kanë filluar hartimin strategjikë e funksionalizimit të Çarshisë së Gjakovës të titulluar me emrin "Hapësira Historike Urbane

¹⁹ Plani i menaxhimit identifikon objektivat, veprimet dhe strategjitë praktike për mbrojtje dhe menaxhim të një ndërtimi/ tërësie. Mes tjerash, kjo i jep dorë dhe shtysë zhvillimit më të gjerë të të qytetit dhe promovon vetëdijesim të komunitetit për trashëgiminë.

²⁰ Neni 4.12; 4.13, Ligji Nr. 02/L-88 (Ligji për trashëgiminë kulturore), http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_al.pdf

²¹ Vendimi u publikua në Gazetën Zyrtare 25/ 82 – nga Intervista me MSc. Dukagjin Bakija, menaxher projekti në CHWB

²² Vendimi nr. 59/ 55 – nga intervista me ark. Osmon Gojani, drejtor i QRTK - Gjakovë

²³ Dokument I QRTK Gjakovë

⁸ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/LISTA_E_TRASHEGIMISE_KULTURORE_PER_MBROJTJE_TE_PERKOHSHME_2014.pdf

- Korniza e funksionalizimit për Çarshinë e Madhe në Gjakovë".²⁵

Komuna, përkatësisht Drejtoria e Urbanizmit ka inicuar procedurat për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Zonën e Çarshisë së Madhe. Pas hartimit, ky plan pritet të miratohet nga Këshilli Komunal si dhe pritet të caktojë saktë zonat funksionale përbrenda zonës së Çarshisë së Madhe, si: Bërthama e Çarshisë; Zona rreth bërthamës së Çarshisë (shtrihet përreth bërthamës së Çarshisë deri te kufiri i zonës); dhe Zona Mbrojtëse e Çarshisë – Buferi²⁶. Këto kushte dhe rregulla në mënyrë të detajuar do të përcaktohen me Planin Rregullues të Hollësishëm. Sipas CHWB-së, pritet që përpara hartimit të PRRH, duhet të bëhet një studim i hollësishëm i konservimit, ku duhet të përcaktohen rregullat dhe masat e ruajtjes së trashëgimisë në përgjithësi në këtë zonë.²⁷

Qendra Historike e Mitrovicës

Përkufizimi i kufijve të zonës së mbrojtur: Bërthama e qytetit të Mitrovicës, që përbëhet fillimisht nga dy mëhalla, u zhvillua rreth objekteve publike dhe atyre të kultit: mesxhidit, përkatësisht xhamisë me medresenë (e ngritur nga Gazi Isa Beu), hanit, hamamit dhe sahat kullës. Krahas krijimit të mëhallëve u krijua dhe Çarshia, e cila fillimisht shtrihet deri tek ura e Ibrit dhe përpjetë Lushtës dhe më vonë ajo u zgjerua edhe në

²⁵ Draft: Çarshia e Madhe – Korniza e Funksionalizimit, autor: CHWB, qershor 2015 dhe intervista me MSc. Dukagjin Bakija, projekt menaxher në zyrën kosovare të CHWB-së.

²⁶ Sipas Ligjit për Trashëgimi Kulturorë, një monument i trashëgimisë kulturore duhet të ketë edhe sipërfaqen e vet mbrojtëse prej rreth 50 - 100 m, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2006_02-L88_al.pdf

²⁷ Draft: Çarshia e Madhe – Korniza e Funksionalizimit, autor: CHWB, qershor 2015 dhe intervista me MSc. Dukagjin Bakija, projekt menaxher në zyrën kosovare të CHWB-së.

jug të rrjedhës së poshtme të Lushtës e deri te kodra Bair. Çarshia e Mitrovicës e përjetoi periudhën e lulëzimit me ndërtimin e hekurudhës Mitrovicë-Shkup-Selanik rreth viteve 1870-tat, duke arritur një numër prej 100 dyqaneve përpara luftërave ballkanike. Në atë kohë çarshia u zgjerua edhe në anën e majtë të lumit Ibër, në lagjen e Muhaxherëve të Bosnjës, ku edhe u krijua “çarshia e re”, si dhe në lindje drejt kishës së sotme ortodokse. Pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht në vitet '50 dhe '60 të shekullit të kaluar, sikurse edhe në Prishtinë dhe në qytete të tjera të Kosovës, pjesë të shumta të çarshisë pësojnë dëmtime. Pjesë të tëra shkatërrohen “për t’i lëshuar vend” ndërtesave të reja të banimit shumëbanesorë dhe atyre administrative. Mirëpo, për një kohë të gjatë do të mbeten pjesët e çarshisë, edhe pse me fasada të ndërruara prej Lushtës drejt kodrës Bair. Çarshia e Mitrovicës pëson shkatërrimin e saj të tërësishëm në luftën e vitit 1999²⁸. Forma e saj e rindërtuar nuk ka asnjë remineshencë të asaj që ajo dikur ka përfaqësuar. Janë po ashtu të pakta monumentet që kanë mbetur në këtë pjesë.

Momentalisht, në qytetin e Mitrovicës, ndërtimet që gëzojnë mbrojtje të shtetit dhe që gjenden në listën e MKRS-së të trashëgimisë kulturore të për mbrojtje të përkohshme, janë:

1. Ndërtesa e Hamamit të Vjetër, shek. XVIII; me shifrën e inventarizimit (nr.v.E.K. 685/57) - e nacionalizuar në vitin 1959.
2. Shtëpi banimi P+1, Koroglu, shek. XIX; me shifrën e inventarizimit (nr.v.E.K. 02-354/78).
3. Hotel Jadran, tani biblioteka Latif Voca, shek. XX

²⁸ Mulolli, E., Punim Diplome, Çarshitë në qytetet e Kosovës, koncepti urbanistik dhe arkitekturor, FNA, UP, 2013, mentor: Mr. Sc. Shqipe Nixha

4. Shtëpi banimi e Zhafer Devës, shek. XIX
5. Kulla e Sherif Gashit, shek. XVIII
6. Kulla e Tupellëve, shek. XX
7. Shtëpia e Spiro Budimirit, shek. XIX
8. Shtëpia e Florim Zenelit, shek. XIX
9. Kulla e Ymer Ymerit, shek. XIX
10. Shtëpia e Avni Boletinit, shek. XX
11. Shtëpia e Nevzat Abrashit, shek. XIX
12. Shtëpia e Arsim Leniqit, shek. XVIII

Përkundër këtij numri të ndërtimeve në qytet të që bëjnë pjesë në listën e mbrojtjes së përkohshme nga shteti, Mitrovica nuk ka një bërthamë historike/ qytet të vjetër të përkufizuar me kufij dhe me status zyrtar të mbrojtjes²⁹.



Fig. 4 Mitrovicë - Shtrirja e ndërtimeve të trashëgimisë, që janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme të MKRS³⁰

Statusi i mbrojtjes së zonës: Në planin e parë hapësinor të evidentuar (1960) për Komunën e Mitrovicës, tema e trashëgimisë kulturore nuk trajtohet fare. Në këtë periudhë kryhen disa nga aktivitetet shkatërruese në emër të krijimit të hapësirës për zhvillimet moderne (ndërtimet e banimit shumëbanesor dhe ato

të administratës), si dhe, sikur edhe gjetiu në Kosovë, të prirë nga leximi ideologjik i kësaj trashëgimie.

Në planin hapësinor komunal të vitit 1988, çështjes së trashëgimisë kulturore i është dhënë një hapësirë pak më e madhe. Pas luftës së vitit 1999, autoritetet komunale fillojnë procesin e hartimit të dokumentit Plani Zhvillimor Komunal, i cili me pëlqim të MMPH-së aprovohet në vitin 2009. As në këtë dokument nuk jepen indikacione në lidhje me caktimin e zonës së vjetër të qytetit nën mbrojtje, as përmes caktimit të kufijve, apo edhe përmes dhënies së një rëndësie të veçantë trajtimit të trashëgimisë në përgjithësi³¹. Në dokumentin e planit rregullues qendra të vitit 2010, theksohet se sa i përket sferës "së trashëgimisë kulturore-historike dhe arkitektonike, tërësi me vlerë të veçantë në hapësirën urbane të Qendrës identifikohet vetëm lokacioni i muzeut të qytetit dhe hamamit duke përfshirë edhe pjesët përreth tij gjerë në akset e rrugëve. Përveç kësaj tërësie me vlerë të veçantë, hapësira urbane e qendrës posedon edhe me një potencial të vogël të objekteve tjera me vlera trashëgimore dhe kulturore, por të cilat ekzistojnë si të mëvetme"³².

Sot, nuk duket që ka ndonjë veprim nga autoritetet lokale dhe qendrore në drejtim të vënies në mbrojtje të asaj që ka mbetur nga qyteti i vjetër, apo edhe çarshia e Mitrovicës. Ndërsa, trashëgimia e qytetit vazhdon të degradohet vazhdimisht, me rastin më eklatant të fundit, kur shtëpia e Xhafer Devës, që ishte në listën e mbrojtjes së përkohshme të MKRS-së u dogj pothuajse tërësisht.

³¹ Studim: Përfshirja e trashëgimisë në planifikim hapësinor, Instituti për Planifikim Hapësinor dhe CHWB, shkurt 2011

³² Plani Rregullues Urban "Qendra" 2010 – 2025+, Kuvendi Komunal Mitrovicë, <http://kk.rks.gov.net/mitrovice/getattachment/Projects/Planet-rregulluse-komunale-2010---2015/Plani-Rregullues-Urban--QENDRA--2010-2015---Pjesa-tekstuale.pdf.aspx>

²⁹ Bisedë me znj. Rrezarta Loxha, drejtoreshë e ORTK-së Mitrovicë

³⁰ Mulolli, E., Punim Diplome: Çarshitë në qytetet e Kosovës, koncepti urbanistik dhe arkitekturor, FNA, UP, 2013, mentor: Shqipë Nixha

Qendra historike e Rahovecit

Përkufizimi i kufijve të zonës së mbrojtur: Drejtoria e Urbanizmit, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit (DUPMM) në bashkëpunim me CHwB-në, janë në proces të përgatitjes së hartimit të PRRH-së 'Qendra e Vjetër e Qytetit'³³. Zona që do të trajtohet me Plan Rregullues të Hollësishëm – PRRH, është përkufizuar nga Drejtoria për Planifikim, Zhvillim Urban, Rural dhe Ambient dhe është territor me sipërfaqe prej 27.50 ha³⁴.




Fig. 5 Zonat e mbrojtura të monumenteve të trashëgimisë kulturore në qytetin e Rahovecit³⁵

Statusi i mbrojtjes së zonës: Komuna e Rahovecit e ka miratuar PZHK-në në vitin 2012. Me ligjin e ri të planifikimit hapësinor, pritet të hartohet Harta Zonale e Komunës. Për shkak të gjendjes së degraduar të trashëgimisë në Rahovec, në këtë rast, shihet e arsyeshme t'i shkohet ndesh procedurës së rregullt të hartimit të PRRH-së pas aprovimit të Hartës Zonale Komunale. Kështu që hartimi i PRRH Qendra e Vjetër e Qytetit të Rahovecit

³³ Prioritet i dalë nga Plani lokal për trashëgimi për komunën e Rahovecit, projekt që zbatohet nga OJQ CHwB

³⁴ Intervisë me z. Dukagjin Bakijën, menaxher projekti në CHwB

³⁵ <http://chwb.org/kosovo/news/drp-old-city-centre-rahovec-is-being-finalised>, qasur më 26 gusht 2015

tashmë është në proces të hartimit³⁶. Sipas hulumtimeve të zhvilluara nga CHwB janë identifikuar rreth 30 objekte të trashëgimisë kulturore të kategorizuara si monumente – teqe, xhami, kulla, shtëpi, konaqe, dhe kroje publike. Nga kjo listë e monumenteve, 9 (nëntë) janë të evidentuara në listën Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si dhe në Qendrën Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren.

1. Kroji i vjetër
2. Teqja e Melamive
3. Sahat Kulla
4. Xhamia e Sokolit
5. Teqja Halveti
6. Kulla e Ismet Qemegës
7. Kullë-shtëpi e Qamil Vuçitërnës
8. Xhamia e Kasumit
9. Kulla e Hajrulla Qantës

Sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) për Komunën e Rahovecit të miratuar në vitin 2013, rekomandohet që të identifikohet dhe të ruhet bërthama e qytetit, dhe në të njëjtën kohë rekomandohet që Teqja e Halvetive të restaurohet dhe të mirëmbahet. Në këtë plan, ky veprim rekomandohet me qëllim të ruajtjes së vlerave kulturore të komunës si dhe me qëllim të nxitjes së zhvillimit ekonomik nëpërmes turizmit.

Qendra historike e Gjilanit

Përkufizimi i kufijve të zonës: Qyteti i Gjilanit aktualisht nuk ka zonë historike të qytetit³⁷. QRTK-së së Gjilanit, dhe autoritetet lokale nuk kanë ndërmarrë deri më tani asnjë hap në këtë drejtim. Kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim pritet të japë CHwB, meqë janë

³⁶ PRRH Qendra e Vjetër në Rahovec është duke u hartuar nga OJQ CHwB. Të dhënat në këtë kapitull janë marrë nga një draft i këtij plani, të cilin CHwB-ja e ka ndarë me ne.

³⁷ Bisedë me drejtorin e QRTK të Gjilanit, z. Artan Hoxha

duke e finalizuar studimin me qëllim të përcaktimit të kufijve të zonës historike të qytetit si dhe evidentimit të zonave mbrojtëse të pasurive natyrore dhe kulturore të komunës së Gjilanit në përgjithësi³⁸.

Zhvillimi i qendrës urbane të Gjilanit nis në shek. XVIII dhe atëbotë njihej si qendër e panairëve tregtare. Historiku i qytetit lidhet me vendosjen e familjes Gjinolli, prej nga edhe qyteti e merr emrin. Më 1900 qyteti kishte 2 xhami, 2 pazare, bazë ushtarake, një kishë, spital dhe një numër shumë të madh të dyqaneve. Qendra e qytetit identifikohet me objektin e Bezistanit, apo çarshinë e mbyllur me shitore të vogla zejtare, kafene e hane dhe me disa kroje. Në afërsi të saj ishin Xhamia Shehzade dhe objekti i Kajmekamit (objekti i sotëm i selisë së kryetarit të Komunës) të ndërtuara paralel me Bezistanin në fillim të shek. XIX. Sipas PRRU Zona 1 e Qendrës³⁹ së qytetit përshin pjesën më të madhe të qytetit të vjetër. Sot, në vendin ku ka qenë Bezistani, ndodhet qendra e re zejtare.

Edhe pse me PZHU të Gjilanit të miratuar në vitin 2008⁴⁰ një nga projektet kyçe të propozuara është edhe revidimi i "Qendrës së vjetër të qytetit"⁴¹, aktualisht në qytetin e Gjilanit, përcaktimi i kufirit të bërthamës historike nuk duket të jetë proces i lehtë, meqë shumë nga ndërtimet e trashëgimisë kulturore në pjesën e vjetër të qytetit nuk janë më. Sipas studimit të CHwB-së, ndërtime të identifikuara me vlera të trashëgimisë

kulturore janë si vijon:

Objektet me vlera të trashëgimisë kulturore të shpallura në LTKMP 2014:

1. Atik Xhamia;
2. Objekti i shkollës së muzikës (ish Saraji i Mustafë Pashës);
3. Shtëpia e Zekirja Abdullahut
4. Objekti i Teknikës Popullore;
5. Objekti i Kajmekamllëkut
6. Shtëpia e Farush Okllapit

Objekte të vlerësuara nga gjilanasit por që nuk janë të shpallura për mbrojtje të përkohshme në LTKMP 2014⁴²:

7. Shtëpia e Jusuf Rexhepit;
8. Mulli uji;
9. Shtëpia e Maksut Malokut;
10. Selia e PDK;
11. Xhamia e Madhe;
12. Sahat Kulla e Vjetër;
13. Konaku i Gjinollëve.

Duke marrë parasysh perimetrin mbrojtës prej 50 - 100 m rreth ndërtimeve, e që përcaktohet sipas ligjit të trashëgimisë kulturore, sipas studimit që po e udhëheq CHwB-ja, zona e propozuar për t'u përkufizuar si bërthamë historike e qytetit të Gjilanit mund të ketë një sipërfaqe rreth 11 ha dhe ka pozitë qendrore të qytetit⁴³.

³⁸ PZHK i Gjilanit I miratuar nga KK 2008

³⁹ PRRU Qendra, Zona 1, KK Gjilan, 2010 [http://kk.rks.gov.net/gjilan/getattachment/47a2e582-52eb-4a37-9f72-73c7021d9e52/PRRU-Qendra-\(pjesa-tekstuale\).aspx](http://kk.rks.gov.net/gjilan/getattachment/47a2e582-52eb-4a37-9f72-73c7021d9e52/PRRU-Qendra-(pjesa-tekstuale).aspx)

⁴⁰ Marrë nga PRRU Qendra, Zona 1, KK Gjilan, 2010 [http://kk.rks.gov.net/gjilan/getattachment/47a2e582-52eb-4a37-9f72-73c7021d9e52/PRRU-Qendra-\(pjesa-tekstuale\).aspx](http://kk.rks.gov.net/gjilan/getattachment/47a2e582-52eb-4a37-9f72-73c7021d9e52/PRRU-Qendra-(pjesa-tekstuale).aspx)

⁴¹ Në vitet e '80 të shekullit të kaluar është hartuar plani detal urbanistik "Pjesa e vjetër e qytetit" - PRRU Qendra, Zona 1, KK Gjilan, 2010 [http://kk.rks.gov.net/gjilan/getattachment/47a2e582-52eb-4a37-9f72-73c7021d9e52/PRRU-Qendra-\(pjesa-tekstuale\).aspx](http://kk.rks.gov.net/gjilan/getattachment/47a2e582-52eb-4a37-9f72-73c7021d9e52/PRRU-Qendra-(pjesa-tekstuale).aspx)

⁴² Të dhëna të ofruara nga z. Dukagjin Bakija, menaxher projekti CHwB

⁴³ <http://chwb.org/kosovo/news/municipality-of-gjilan-defines-heritage-protective-zones/>




Fig. 6 Zonat e mbrojtura të monumenteve të trashëgimisë kulturore në qytetin e Gjiłanit⁴⁴

Statusi i mbrojtjes së zonës: Në vitet e '80 të shekullit të kaluar është hartuar plani detal urbanistik "Pjesa e vjetër e qytetit", dhe sipas PZHU-së së vitit 2008 propozohet revidimi i këtij plani. Por përkundër kësaj kjo zonë nuk ka pasur asnjëherë status të mbrojtjes nga shteti si bërthamë historike e qytetit të Gjiłanit. Nga puna që aktualisht po kryhet nga CHwB-ja, pas përkufizimit të kufijve të zonës së mbrojtur, priten hapa të tjerë që duhet të ndërmerren nga pushteti lokal me përkrahje nga MKRS-ja, për t'i dhënë statusin e zonës së mbrojtur, dhe të hartohen studimet për konservimin dhe planin rregullues të hollësishëm, që do të përcaktonte masat e mbrojtjes dhe zhvillimit të kësaj zone, me qëllim të ndalimit të degradimit të mëtutjeshëm të trashëgimisë kulturore në këtë qytet.

Qendra Historike e Pejës

Përkufizimi i kufijve të zonës së mbrojtur: Qyteti dhe rrethina e Pejës, përpos peizazhit natyror të jashtëzakonshëm, karakterizohet me lokalitete të shumta arkeologjike, por edhe me një numër të madh të ndërtimeve dhe tërësive të trashëgimisë kulturore. Disa

⁴⁴ <http://chwb.org/kosovo/news/municipality-of-gjilani-defines-heritage-protective-zones/>

nga këto ndërtime dhe lokalitete kanë gëzuar mbrojtje nga shteti që nga vitet e '50 të shekullit XX dhe tutje, si dhe vazhdojnë të jenë të listuara në listën e trashëgimisë për mbrojtje të përkohshme të MKRS-së. Në Pejë gjendet edhe një nga pronat e trashëgimisë nën mbrojtjen e UNESCO-s⁴⁵, Patrikana e Pejës, e cila po ashtu është e shpallur edhe si zonë e veçantë e mbrojtur⁴⁶. Me gjithë këtë shumësi ndërtimesh dhe ansamblesh nën mbrojtje të shtetit, qyteti i Pejës nuk ka një bërthamë historike të përcaktuar me kufij dhe të cilit i është dhënë status i mbrojtjes ligjore⁴⁷.

Në PZHU të komunës së Pejës të vitit 2006, përkufizimi i një bërthame historike, e cila do t'i përmbledhte ndërtimet e trashëgimisë dhe e cila vihej nën mbrojtje të shtetit, nuk përmendet si objektivë e qartë strategjike e zhvillimit urban. Edhe pse, në këtë dokument përmendet se njëra ndër sfidat e identifikuar (...) *është trashëgimia dhe zhvillimi i qëndrueshëm, sipas të cilës: Trashëgimia natyrore dhe kulturore e komunës është në rrezik të shkatërrimit dhe nevoja e një zhvillimi të qëndrueshëm duke i shfrytëzuar dhe mbrojtur vlerat për të ardhmen e fëmijëve tanë*⁴⁸.

Duke qenë se çështja e trashëgimisë kulturore është pjesë përbërëse edhe e deklaratës së vizionit të PZHU-së dhe PZHK-së, del se trashëgimia kulturore për komunën e Pejës

⁴⁵ Patrikana e Pejës është nën mbrojtjen e UNESCO-s që nga viti 2006. Kjo pronë gjendet me ID 724-002bis, në grupin Monumenteve Mesjetare në Kosovë, të sponsoruar nga Serbia, <http://whc.unesco.org/en/list/724>

⁴⁶ Sipas ligjeve të dala nga Pakoja e Ahtisaarit (neni 7.1/b, Ligji për Zonat e Veçanta të mbrojtura, Nr. 03/L-039)

⁴⁷ Të dhënat nga QRTK – Pejë, të përgatitura nga drejtoresha Shpresa Gjonbalaj.

⁴⁸ Studim: Përfshirja e trashëgimisë në planifikim hapësinor, Instituti për PLANifikim Hapësinor dhe CHwB, shkurt 2011

është një nga çështjet më të rëndësishme.⁴⁹ Në planet rregulluese që kanë dalë nga plani zhvillimor urban, për zonën që përmban çarshinë e gjatë, e që supozohet të jetë bërthamë për një qendër historike më të gjerë në këtë qytet, nuk gjejmë ndonjë elaborim më të gjerë, me çka do të sinjalizonte një vullnet për përkufizimin e një zone historike të qytetit të mbrojtur nga shteti. Për më tepër ndarja e zonave të qytetit sipas PZHU-së, është bërë asisoj që shumësia e monumenteve që tashmë gëzojnë mbrojtje janë të shkapërderdhura nëpër zonat e ndryshme të qytetit.



Fig. 7 Një harta e shtegut kulturor në Pejë që përfshin shumicën e monumenteve të trashëgimisë brenda saj⁵⁰

Kur flasim për një bërthamë të qendrës historike të Pejës, duhet përmendur çarshinë e Pejës, që dikur përbëhej prej dy tërësive organikisht të lidhura, çarshisë së lartë dhe çarshisë së gjatë⁵¹. Çarshia e lartë u shkatërrua menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore, njësoj sikurse edhe çarshia në Prishtinë dhe në Mitrovicë, për t'iu bërë vend zhvillimeve të reja urbanistike. Ndërsa, ajo që mbeti ishte Çarshia e Gjatë, e cila me shumë intervenime, qëndroi deri sa u dogj gjatë luftës së fundit në Kosovë. Pas luftës, pronarët

me iniciativë vetanake ndërmorën rindërtimin e dyqaneve të veta duke u bazuar në projektin për revitalizimin edhe regjenerimin e saj, të hartuar 10 vjet më parë nga IMMK⁵².




Fig. 8 Kufijtë e çarshisë së Pejës, Plan për revitalizimin dhe regjenerimin e çarshisë, punuar nga IMMK Prishtinë, 2004/5

Statusi i mbrojtjes së zonës: Sipas zyrtarëve të QRTK-së së Pejës, shumica e objekteve të trashëgimisë kulturore (me përjashtim të Çarshisë së Gjatë) në këtë qytet qëndrojnë si të ndara e jo si tërësi (komplekse) objektivsh arkitektonike⁵³. Peja disponon me tërësinë urbanistike të Çarshisë së gjatë, si dhe objekteve përreth që kanë vlerë kapitale historiko-ekonomike dhe natyrisht kanë statutin e monumenteve nën mbrojtje të përkohshme në listën në mbrojtje të përkohshme të MKRS-së. Sipas drejtoreshës znj. Gjonbalaj, kjo zonë mund të identifikohet si Qendra Historike e Pejës. Në afërsi të çarshisë gjenden komplekset si vijon: Çarshia e Vjetër e Pejës, Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës, Kompleksi i Konakut të Jashar Pashës, Kompleksi i Hamamit të Haxhi Beut, Kompleksi i Kullave, por edhe ndërtimet, Konaku i Tahir Beut, Kulla e Jashar Pashës, Kroi te Shatërvani, Ndërtesa e Shkollës së parë shqipe, etj. Përpos tyre, në Pejë janë edhe mbi 55 monumente dhe tërësi që janë të pjesë e listës së trashëgimisë për mbrojtje të përkohshme nga shteti, sipas përditësimit të

⁴⁹ Nga dokumenti i PZHU-së Pejë, aprovuar më 2007 (marrë nga *Konservimi i Integruar*, Report Series, 24/ 2011, CHwB)

⁵⁰ Hartë e punuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik/ Divizioni i Turizmit në bashkëpunim me IMMK Pejë

⁵¹ Drancolli, F., Studim: Tarashëgimia ndërtimore në Pejë – Çarshia e vjetër në Pejë, IMMK, Prishtinë, 2004

⁵² Gashi, G., Projekti për revitalizimin dhe regjenerimin e çarshisë së Pejës, IMMK 2004/5

⁵³ Të dhënat nga QRTK – Pejë, të përgatitura nga drejtoresha Shpresa Gjonbalaj.

fundit⁵⁴. Me gjithë këtë shumësi ndërtimesh dhe ansamblesh nën mbrojtje të shtetit, qyteti i Pejës nuk ka një bërthamë historike të përkufizuar dhe të përcaktuar me kufij dhe të cilit i është dhënë status i mbrojtjes ligjore⁵⁵.

Qendra historike e Vushtrrisë

Përkufizimi i kufijve të zonës: Vushtrria, njëri nga qytetet më të vjetra në Kosovë, me një zhvillim të konsiderueshëm ekonomik dhe shoqëror gjatë shekujve të kaluar, sot ka shumë pak ndërtime dhe tërësi të ruajtura për ta dëshmuar këtë të kaluar. Shumë pjesë të qytetit të vjetër janë shkatërruar dhe degraduar pas luftës së dytë botërore, gjatë periudhës së zhvillimit modern të qytetit, mirëpo shkatërrimin më të madh ky qytet e ka pësuar në luftën e fundit në Kosovë. Degradimi vazhdoi edhe pas luftës falë neglizhencës së institucioneve lokale dhe të atyre qendrore, duke lejuar, mes tjerash, edhe intervenime në prona të trashëgimisë, që shkelin normat ndërkombëtare dhe parimet e konservimit të një monumenti të trashëgimisë, etj.

Në planin zhvillimor urban të vitit 2009⁵⁶, gjatë përshkrimit të destinimit të sipërfaqeve të qytetit të Vushtrrisë, në mënyrë të përgjithësuar përmenden ndërtesat kulturore dhe fetare dhe përfshirja e tyre në hapësira të caktuara të qytetit. Destinimi i sipërfaqeve jepet në mënyrë skematike, në modelin e zhvillimit hapësinor të qytetit, dhe brenda

kësaj skeme përveç tjerash jepen edhe ndërtesat kulturore dhe historike.⁵⁷

Së fundmi, si një nga prioritetet e dala nga projekti Planet Lokale të Trashëgimisë, të udhëhequr nga organizata CHWB dhe e bashkëfinancuar nga Suedia dhe nga Komuna e Vushtrrisë, filloi hartimi i planit të konservimit të qendrës historike të Vushtrrisë. Kjo qendër historike përkufizohet përbrenda trekëndëshit ndërmjet Urës së Gurit, Hamamit dhe Kalasë. Kjo zonë është përcaktuar si e tillë në Planin Zhvillimor Komunal të Vushtrrisë⁵⁸. Ky plan i konservimit do të përmbajë dispozitat e ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe udhëzuesin për zhvillim dhe planifikohet të përmbillet në gjysmën e parë të vitit 2016⁵⁹.



Fig. 9 Projektioni për qendrën historike të Vushtrrisë e vendosur në trekëndëshin ndërmjet Urës së Gurit, Hamamit dhe Kalasë⁶⁰

Statusi i mbrojtjes së zonës: Momentalisht përbrenda qytetit të Vushtrrisë, gjenden monumentet dhe tërësitë e trashëgimisë kulturore që janë të evidentuara në listën e

⁵⁴ http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/LISTA_E_TRASHËGIMISE_KULTURORE_PER_MBROJTJE_TE_PERKOHSHME_2014.pdf

⁵⁵ Të dhënat nga ORTK – Pejë, të përgatitura nga drejtoresha Shpresa Gjonbalaj

⁵⁶ Konservimi i integruar, sfidat dhe përvojat e integrimit të trashëgimisë kulturore dhe natyrore në planifikim hapësinor dhe urban në Kosovë, CHWB Kosovo Office, Report Series No. 24/2011 http://chwb.org/kosovo/wp-content/uploads/sites/3/2014/09/Publication_2011_13.pdf, qasur më 21 korrik 2015

⁵⁷ Po aty

⁵⁸ Aktualisht PZH dhe PZHU të miratuara në vitin 2009 janë në proces të revidimit. Gjatë muajve të verës janë duke u mbajtur debate publike me qytetarë për skenarët e zhvillimit të qytetit, <https://kk.rks.gov.net/vushtrri/News/Debati-publik-per-Planin-Zhvillimor-dhe-Urbanistik.aspx>

⁵⁹ <http://chwb.org/kosovo/news/the-conservation-plan-of-vushtrri-starts-to-be-drafted-2/?lang=sq>

⁶⁰ <http://chwb.org/kosovo/news/the-conservation-plan-of-vushtrri-starts-to-be-drafted/>

MKRS-së për mbrojtje të përkohshme. Disa e gëzojnë mbrojtjen prej 50 – 60 vitesh, ndërsa të tjera janë me statusin e propozuar përbrenda kësaj liste.

1. Ura e vjetër e gurit, mesjetë, nr. vendimit: 859/49 (fus, sipas Pakos së Ahtisaarit kjo urë, emërtimi Ura mesjetare e Vojinoviçëve, është e shpallur si zonë e veçantë e mbrojtur (fus neni 7.3/ d, Ligji për zona të veçanta - Nr. 03/L-039)
2. Kështjella “Kalaja”, Kulla e vjetër, mesjetë, nr. vendimit: 858/ 49
3. Nishani i Mustafë Beut në xhaminë e Gazi Ali Beut, 1538, nr. vendimit: 02 - 957/66
4. Xhamia e Gazi Ali Beut, 1444, nr. vendimit: 02 -985/66
5. Hamami i vjetër, shekulli XVI, nr. vendimit: 02 -628/68
6. Shtëpi – Shaban Aga, shek. XIX
7. Shtëpi - Mahmut Pashë Gjinolli, shek. XX

Sipas ligjit për Planifikim Hapësinor (neni 18/2, Ligji Nr. 04/L-174), këto monumente/ tërësi duhet të gëzojnë një zonë mbrojtëse me rreze prej 50 – 100 m, sipas përcaktimit nga institucionet përkatëse. Në Planin Zhvillimor Komunal zona e cila është e identifikuar si qendër historike të Vushtrrisë, është pikërisht trekëndëshi ndërmjet Hamamit, Urës së Gurit dhe Kalasë, dhe monumentet e sipërpërmendura janë brenda apo në afërsi të kësaj zone.

V. Rekomandime

Përcaktimi i kufijve të bërthamës historike dhe caktimi i statusit mbrojtës: Sipas Ligjit për Planifikim Hapësinor (Ligji Nr. 04/L-174), secila komunë duhet të hartojë Hartën Zonale Komunale, e cila përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të

hapësirës dhe masat e veprimit⁶¹. Sipas pikës 2.8 të nenit 16 në këtë ligj, Harta Zonale e Komunës përcakton sipërfaqet dhe masat për zhvillimin e turizmit dhe mbrojtjen e trashëgimisë. Një numër i komunave të Kosovës janë në proces të hartimit të këtyre hartave dhe pas miratimit të tyre nga Kuvendet Komunale përkatëse, do të duhej të pasonte punimi i planeve rregulluese të hollësishtme për zonat e dala nga kjo hartë dhe nga Plani Zhvillimor Komunal⁶².

Gjatë hartimit të planeve zhvillimore komunale si dhe Hartave Zonale të Komunës, komuna në bashkërendim me MKRS-në, QRTK-të, por edhe me përfshirjen e profesionistëve nga shoqëria civile, përgatisin studimin për bërthamat historike të qyteteve përkatëse. Krahas ndërtimeve dhe tërësive tashmë të përfshira në listën e shtetit për mbrojtje të përkohshme të asaj zonë, bëhet inventarizimi i pronave të tjera në bashkëveprim dhe konsultim me qytetarët.

Qendrat historike urbane paraqesin zona të qytetit të përkufizuara, që përmbajnë një numër të koncentruar të objekteve/tërësive, të cilat kanë një vlerë ose më shumë vlera që ndërlidhen në aspektin historik, arkitekturial, arkeologjik ose kulturor. Duke marrë parasysh se sipas ligjit për trashëgimi kulturore pronat e mbrojtura të trashëgimisë kanë një zonë mbrojtëse me rreze prej 50 – 100 m⁶³, duhet bërë përcaktimi i kufijve të zonës historike. Pas vlerësimit dhe shqyrtimit nga organet kompetente të MKRS-së⁶⁴ bëhet shpallja zonës nën mbrojtje nga KKTK-ja, si dhe bëhet përfshirja e qendrës historike në listën e

⁶¹ Neni 16/1, Ligji Nr. 04/L-174

⁶² Pika 1 neni 18, Ligji Nr. 04/L-174

⁶³ Neni 6.4, përkatësisht 7.16 i Ligjit për trashëgimi kulturore Ligji nr.02/L-88

⁶⁴ Neni 4 i Ligjit nr. 02/L-88; Asetet trashëgimisë kulturore që propozohen për mbrojtje vlerësohen nga institucioni kompetent dhe vendimi për mbrojtje përcaktohet nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe nënshkruhet nga Ministri (MKRS).

trashëgimisë kulturore të mbrojtur nga shteti. Si zonë e tillë e përcaktuar me kufij të qartë duhet të evidentohet në hartën zonale të komunës⁶⁵.

Nga raporti i mësipërm del se disa nga qytetet e përfshira në këtë raport kanë nisur procesin e përcaktimit të kufijve të një zone historike/ qyteti të vjetër. Nga ky raport del se, bazuar në shqyrtimin e objektivave të shtruar planet hapësinore dhe strategjike të tyre, ka edhe qytete (përfshirë edhe disa që nuk janë përfshirë në hulumtim), që përcaktimin e një qendre historike dhe vënien e saj nën mbrojtje të shtetit nuk e kanë prioritet për zhvillimin e përgjithshëm të qytetit.

Jemi dëshmitarë që qyteteve tona, përditë e më shumë kujtesa po iu zbehet, meqë edhe ato pak gjurmë që kanë mbetur nga pjesët të vjetra të qyteteve, janë në gjendje të mjerueshme. E, pikërisht vullneti i munguar i një komune për të vënë nën mbrojtje atë pjesë të kujtesës që ka mbijetuar në qytet, paraqet grushtin më të fuqishëm që po i jepet degradimit të trashëgimisë ndërtimore, por edhe zhvillimit të qyteteve në përgjithësi.

Hartimi i planit të konservimit: Hartimi i një plani të konservimit për një qendër historike është i nevojshëm për t'i përcaktuar masat e mbrojtjes së pronave të trashëgimisë, por edhe për t'i përcaktuar rregullat dhe për t'iu dhënë drejtim zhvillimeve të mëtutjeshme të asaj zone urbane në përgjithësi. Plan i konservimit është një dokument, i cili shpjegon se pse një vend është i rëndësishëm dhe se si duhet të ruhet ajo vlerë, pavarësisht ripërdorimit adaptiv, ndryshimit, riparimit apo menaxhimit të saj. Planet e konservimit janë

⁶⁵ Sipas Ligjit të Kosovës për trashëgimi kulturore nga viti 2006 gëzojnë një status tjetër, atë të mbrojtjes së përkohshme. Ky status duhet të ri-shqyrtohet çdo vit. Statusi mbrojtje e përkohshme vazhdohet sipas procedurës së rishikimit dhe rivlerësimit çdo vit, dhe si produkt final ka Listën e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme.

udhëzues në një numër projektesh ose intervenimesh në zona historike, përfshirë: Intervenimet konservuese për ruajtje; intervenimet për ripërdorim adaptiv; rehabilitim të ndërtimeve; Stabilizimi të ndërtimeve; Shtesa, Dizajn urban, struktura të reja në kontekstin historik, si dhe rritjen e qasjes në zonë⁶⁶.

Hartimi i planit të menaxhimit: Plan i Menaxhimit të Trashëgimisë ka për qëllim që të sigurojë që trashëgimia e llojllojshme e një qytetit të mbrohet tani dhe për të ardhmen. Me të përcaktohen rregullat e administrimit të zonës. Qëllimi i një plani të menaxhimit të një qendre historike apo tërësie duhet të jetë: të mbrojë trashëgiminë ndërtimore dhe të promovojë vetëdijen për trashëgiminë e pasur, në mënyrë që të sigurojë që kujdesi ndaj trashëgimisë; të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes, të jenë në qendër të zhvillimit të qytetit⁶⁷.

Pavarësisht planit të konservimit, që një qendër historike mund ta ketë të hartuar, pa plani të menaxhimit, degradimi i trashëgimisë dhe i qytetit nuk ndalon. Për ta ilustruar këtë, po e marrim shembullin e qytetit të Prizrenit, i cili përkundër Planit të Konservimit të Qendrës Historike të miratuar nga KK në vitin 2009, si dhe kornizën ligjore dhe sistemin institucional në fuqi, Qendra Historike e Prizrenit po degradohet në vazhdimësi⁶⁸.

⁶⁶ Conservation Planning Methodology Developing policies for the Conservation of Historic Places, https://www.for.gov.bc.ca/ftp/heritage/external/!public/web/Conservation_Planning_Methodology.pdf

⁶⁷ <http://www.lethbridge.ca/Doing-Business/Planning-Development/Historic-Building-Preservation/Documents/Heritage%20Management%20Plan.pdf>

⁶⁸ Ligjet nuk e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit, EC Ma NDryshe, prill 2014, http://online-transparency.org/repository/docs/Ligjet_nuk_po_e_mbr_ojne_QH.pdf

VI. Konkluzion

Sot, nocioni i qëndrueshmërisë urbane dhe i "qyteteve të gjalla" karakterizohet nga zotërimi i një trashëgimie unike historike. Impakti i rritjes së qyteteve nuk do të duhej të rrezikonte kontinuitetin e kujtesës kolektive të zonave urbane, por ruajtja e kujtesës kolektive urbane dhe me këtë ruajtja e zonave historike të qytetit duhet të jenë pjesë e pandashme e konceptimit bashkëkohor të zhvillimit të qytetit.

Termi kryesor për mbrojtjen e vendeve historike është konservimi, që mund të përshkruhet si të gjitha veprimet a proceset që synojnë ruajtjen e elementeve përcaktuese të karakterit të një vendi historik për të mbajtur vlerën e saj të trashëgimisë dhe për të zgjatur jetën e tij fizike. Kjo ruajtje përfshin mbrojtjen, ruajtjen dhe stabilizimin e formës dhe materialeve ekzistuese, si dhe të integritetit të një vendi historik apo të një komponente individuale, njëkohësisht duke mbrojtur vlerën e saj të trashëgimisë. Ruajtja mund të përfshijë masa të shkurtra dhe afatmesme për të mbrojtur ose stabilizuar vendin, si dhe veprimet afatgjata për të larguar përkeqësimin ose edhe për të parandaluar dëmtimin. Kjo e fundit do të mundësojë

evitimin e dëmtimeve afatgjata përmes mirëmbajtjes rutinore dhe riparimeve të vogla.

Qendra historike duhet të jetë një shembull pozitiv i një zone që ka ruajtur strukturën e saj historike urbane duke iu përgjigjur, me kalimin e kohës, funksioneve gjithnjë e më komplekse të një qyteti modern.

Qendrat historike urbane në Kosovë janë shembuj të zonave të degraduara, struktura urbane historike e të cilave nuk ka mundur t'i përballojë kërkesat aktuale të tregut, ekonomisë dhe interesat private, etj. Një nga veprimet urgjente që institucionet tona duhet të ndërmarrin drejt mbrojtjes së kujtesës kolektive të qyteteve tona, është vënia nën mbrojtje e këtyre tërësive. Me hartimin e dokumenteve që rregullojnë dhe përvijojnë masat që duhet të ndërmerren për konservimin por edhe menaxhimin e këtyre zonave, me një perspektivë të zhvillimit të qëndrueshëm urban, në përgjithësi shpresojmë, që përfundimisht, do të ndalojë trendi i degradimit, dhe trashëgimia, mes tjerash, do të vihet në funksion të zhvillimit të përgjithshëm kulturor, shoqëror dhe ekonomik të qyteteve tona.

EC Ma Ndryshe

EC është organizatë e komunitetit, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për avansimin e demokracisë në nivel lokal në Kosovë. Organizata punon me një numër të konsiderueshëm grupesh të komunitetit, si dhe mirëmban një presion të përhershëm ndaj qeverive lokale për qeverisje gjithëpërfshirëse, transparente dhe llogaridhënëse. EC angazhohet për qytetari aktive në formësimin e ambientit jetësor duke nxitur organizim të mirëfilltë të komunitetit, demokratizim të institucioneve dhe pasurim të jetës kulturore në qendrat kryesore të Kosovës, me fokus në Prizren dhe Prishtinë.

Nga janari i vitit 2015, EC funksionon me këto tri programe:

- *Qyteti Gjithëpërfshirës (mobilizim i komunitetit)* – Mobilizimi i komunitetit përbën thelbin e punës së EC-it. Identiteti i organizatës rrjedh nga angazhimi komunitar. Qyteti Gjithëpërfshirës do të jetë programi më i rëndësishëm i organizatës dhe do të përfaqësojë tiparin dallues të EC-it në raport me organizatat tjera të shoqërisë civile. Pjesë e këtij programi do të jenë veprimet që nxisin aktivizmin qytetar në nivel të grupeve të komunitetit (kryesisht lagjet urbane),
- *Qeverisja e mirë (monitorim dhe avokim)* – Për t'u siguruar që qeveria lokale vepron në përputhje me kërkesat dhe interesat e grupeve të komunitetit dhe për të mbajtur gjallë presionin publik ndaj autoriteteve, programi i Qeverisjes së Mirë do të strukturohet rreth aktivitetit të monitorimit të transparencës dhe rolit watchdog të organizatës. Monitorimi është një ndër tiparet më dalluese të punës së EC-it, ndërsa ai është dizajnuar në atë formë që do t'i ushqejë dy programet e tjera të organizatës me informacion të bazuar, të shpejtë dhe kredibil.
- *Hulumtimi (prodhim i dijes)* – Prodhimi i dijes do të jetë një nga sferat e angazhimit të përhershëm të organizatës. Duke ndërtuar mbi produktet e hulumtimit të prodhuara në vitet e fundit, organizata do të ndërtojë një sistem të strukturuar të hulumtimit dhe prodhimit të dokumenteve të politikave. Programi i hulumtimit do të forcojë edhe më tutje kapacitetin prodhues të organizatës dhe do të përmirësojë kompetencën profesionale në fushat e ngushta të angazhimit.

Tiparet dalluese të EC janë: një, fokusi gjeografik, dhe dy, qasja ndaj çështjeve të interesit. E bazuar në Prizren dhe Prishtinë, organizata përdor qasje antropologjike në hulumtimin dhe zhvillimin e politikave. Si rezultat, produktet e hulumtimit të organizatës ofrojnë përmbajtje të besueshme, pasi që merren me thelbin e problemit në vend se me simptomat. Për më tepër, EC mbulon fusha të veçanta sikur planifikimi urban, politikat kulturore, menaxhimi i hapësirës publike dhe të ngjashme, të cilat janë përgjithësisht të nëntrajtuara në Kosovë. Aktiviteti hulumtues dhe aktivizmi *grassroots* i organizatës janë metoda pune të kombinuara mirë dhe të ndërvarura. Përmes aktivizmit, EC angazhohet në mënyrë të përhershme në punë me grupet e komunitetit për t'i identifikuar nevojat e tyre, të cilat janë burime që e ushqejnë komponentën e hulumtimeve. Kjo metodologji mundëson ndikim më të madh tek agjenda e politikëbërjes, pasi që idetë vijnë nga poshtë, ndërsa paralelisht krijohen mundësi për përfshirjen e politikëbërësve në një debat konstruktiv dhe të mirëinformuar. Me këtë qasje, organizata ndikon në pjesëmarrje më të gjerë publike dhe procese më gjithëpërfshirëse të zhvillimit të politikave publike.

Projektet kryesore të organizatës gjatë viteve të fundit: EC për qytete transparente dhe gjithëpërfshirëse (2015 – 2016), Indeksi i Reformës së Transparencës Komunale (2015 – 2016), Urbanizmi I Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2016), Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 – 2015), Qyteti Gjithëpërfshirës, planifikim me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014 – 2016), Zhvillimi rajonal përmes turizmit kulturor (2014 – 2015), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore e zhvillimit lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2015), Pjesëmarrja publike në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2012 – 2013), Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 – 2015), Një tregim ballkanik (2011 – 2012), Aktivizmi qytetar për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore (2009 – 2010).

Publikimet e fundit të organizatës: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore (kontribut për raportin e Progresit) (2015), (Pa)drejtësia në urbanizmin e Prizrenit (2015), Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren (2015), Katalogu i Rajonit të Prizrenit (2015), Planifikim urban për qytetarët (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Ku është kalldrëmi i Prizrenit? (2014), Paraja publike si "paret e babës" (2014), Udhëzues për transparencën në komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike të Prizrenit (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014).